



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 589/1 Prot.

Tiranë, më 16 / 04 / 2019

V E N D I M

Nr. 53, Datë 16 / 04 / 2019

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 06, datë 23.01.2019, të bërë nga N.L¹ kundër Kopshtit Nr. 11 Korçë dhe Drejtorisë Arsimore Rajonale Korçë, në të cilën pretendohet për diskriminim të djalit të saj, për shkak të “racës” dhe “aftësisë së kufizuar²”. Në formularin e ankesës nuk identifikohet, Bashkia Korçë si subjekt që pretendohet të ketë kryer diskriminim, por u pa e arsyeshme të kërkohej informacion dhe nga ky institucion, pasi është përgjegjës³ për administrimin e institucioneve parashkollore. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, ankuesja informon se: *“Komisioni Multidisiplinar i DAR Korçë ka rekomanduar vendosjen e një mësuesi ndihmës për fëmijën e saj. Në Shtator 2018 ka regjistruar fëmijën e saj në Grupin e Parë të Kopshtit nr.11, por duke patur një mosmarrëveshje me mësuesen e Grupit të Parë, pasi mësuesja nuk pranoi ta mbante fëmijën e ka transferuar në Grupin e Dytë. Gjatë frekuentimit të kopshtit ka vënë re se fëmija i saj nuk përfshihet në lojërat me bashkëmohatarët e tij, nuk i kushtohet vëmendje e veçantë dhe nuk punohet me një plan edukativ individual për fëmijën e saj. Për këto arsye i është drejtuar psikologes dhe organeve drejtuese për vendosjen e mësuesit ndihmës, por pa rezultat”*.

¹ Në cilësinë e prindit të fëmijës Xh.L.

² Shtetasja N.L deklaron se i përket komunitetit egjiptian dhe se fëmija i saj vuan nga sindroma: “Çrregullim i spektrit autik”.

³ Referuar pikës 2 të Kreut III, të Udhëzimit të Përbashkët nr.27, datë 16.8.2018 “Për vitin shkollor 2018-2019 në sistemin arsimor parauniversitar”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe vendosjen e një mësuesi ndihmës.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Neni 7 i LMD-së⁴, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”*.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 06, datë 23.01.2019 të N.L u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 126/1, datë 31.01.2019, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga, Bashkia Korçë, DAR Korçë dhe Kopshti nr.11 për ankesën e bërë nga N.L.

Me shkresën nr. 67/1, datë 06.02.2018, DAR Korçë në mes të tjerash informoi se: *“Bazuar në ligjin nr. 69/2012 “Për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 55/1, qartëson se Drejtori i institucionit arsimor parashkollor emërohet dhe shkarkohet nga Kryetari i Vetëqeverisjes Vendore. Mësuesi parashkollor emërohet nga Drejtori i institucionit*

⁴ Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

arsimor parashkollor sipas renditjes së portalit. Me shkresën nr.11879, datë 15.11.2018, MASR ka urdhëruar delegimin e renditjes së portalit, Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, çka ka deleguar plotësisht tek Bashkitë përgjegjësinë për zbatimin e legjislacionit për emërim të drejtorëve dhe mësuesve të institucioneve parashkollore. Sipas shpjegimeve përkatëse, DAR Korçë nuk ka më në juridiksionin e saj emërimet në institucionet parashkollore”.

Me shkresën nr.6, datë 13.02.2019, Kopshti nr.11, Korçë në mes të tjerash informoi se: “Fëmija Xh.L është regjistruar në kopësht në grupin e parë në datë 13.09.2018. Në momentin e regjistrimit nëna e tij nuk ka shprehur asnjë lloj problematike lidhur me zhvillimin e fëmijës. Në vijim të frekuentimit të kopshtit, mësuesit konstatuan që fëmija ishte përdorues i bebelinos dhe shfaqte vështirësi në komunikim dhe ndërveprim. Pas kësaj prindit iu kërkua nga komisioni i vlerësimit me bazë kopshti, më shumë informacion lidhur me zhvillimin e fëmijës dhe ecurinë e deritanishme. N.L sqaroi se fëmija ishte vlerësuar në një qendër për zhvillimin e fëmijëve në Tiranë me diagrozën: Çrregullim të spektrit autik, vlerësim të cilin nuk e ka vënë në dispozicion të komisionit. Pas frekuentimit të tri ditëve të para në grupin e parë, prindi shprehu dëshirën për ta larguar nga ky grup dhe për ta kaluar në një klasë tjetër. Pas kësaj kërkesë, komisioni i vlerësimit vendosi që bazuar në kërkesën e prindit dhe në faktin se po në të njëjtin grup u identifikua dhe një fëmijë tjetër me probleme në zhvillim, kalimin e fëmijës në një klasë tjetër. Gjatë kësaj periudhe, në marrëveshje paraprake me prindërit e fëmijës si dhe për shkak të frekuentimit jo të rregullt të fëmijës, u vendos që fëmijës t’i lihet një periudhë kohe për tu përshtatur me mjedisin, fëmijët dhe mësueset apo kohë gjatë të cilës stafi i kopshtit të kuptonte/vlerësonte nevojat e tij. Kjo periudhë do të shërbente gjithashtu edhe për hartimin e planit edukativ individual. Gjatë kësaj periudhe, pavarësisht frekuentimit jo të rregullt mësueset e klasës kanë punuar me përkushtim për përfshirjen e fëmijës dhe familjarizimin e tij me fëmijët e grupit si dhe nxitjen e interesit të tij ndaj aktiviteteve mësimore. Në përfundim të kësaj periudhe, në datë 19.12.2018 është realizuar takimi i komisionit të vlerësimit me prindin e fëmijës dhe në prani të mësueseve të grupit si dhe punonjëset e shërbimit psiko-social. Gjatë këtij takimi u hartua PEI i fëmijës. Sqarojmë se deri në këto momente, nëna e fëmijës nuk kishte dorëzuar raportin e vlerësimit shëndetësor si dhe nuk kishte informuar që fëmija ishte përfitues i KMCAP. Pasi u ra dakord në lidhje me objektivat, u lanë disa ditë kohë për plotësimin e dokumentit të PEI-it si dhe firmosja e tij. Mësueset e fëmijës kanë një eksperiencë dhjetëvjeçare në arsimin parashkollor me kualifikime në fushën e aftësisë së kufizuar. Që prej kësaj date, prindi nuk është paraqitur më në kopësht. Për festat e fundvitit, mësuesja e klasës ka informuar prindin për organizimin e koncertit të fundvitit me qëllim pjesëmarrjen e fëmijës dhe familjes në këtë aktivitet, por fëmija nuk mori pjesë. Nga interesimi i mëvonshëm për shkak të mosfrekuentimit të fëmijës, u informuam që familja e fëmijës po planifikonte për tu larguar nga Shqipëria. Në lidhje me prezencën e mësuesit ndihmës, sqarojmë se fëmija nuk është vlerësuar nga Komisioni Multidisiplinar i vlerësimit të fëmijëve me nevoja të veçanta pranë DAR-it. Në një rast të ngjashëm, Kopshti nr.11 me shkresën nr.513, datë 4.10.2018 i është drejtuar DAR-it, në të cilën ka kërkuar emërimin e një mësuesi ndihmës për një fëmijë tjetër të kopshtit i cili ishte rekomanduar për mbështetje me mësues ndihmës. Aktualisht në kopshtin nr.11 dhe në kopshtet e tjera nuk është vendosur asnjë mësues ndihmës”.

- Me shkresën nr. 438, datë 20.03.2019, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar dhe njëherë nga Bashkia Korçë, informacion lidhur me caktimin e mësuesit ndihmës në kopshtet që administrohen nga Bashkia Korçë.

Me shkresën nr. 824/2, datë 25.03.2019, të dërguar pranë Komisionerit, Bashkia Korçë në mes të tjerash informoi se: *“Pas reformës territoriale, kompetenca për mbështetjen e institucioneve të arsimit parashkollor i kaluan Bashkisë, megjithatë emërimi i mësuesve në kopshte nuk ishin ende në kompetencën e bashkisë, deri në momentin e ndryshimeve të ligjit 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në RSH”, i ndryshuar⁵. Gjithashtu, Bashkia Korçë nuk ka një buxhet të miratuar për vitin 2019 për pagat e mësuesve ndihmës, por është duke mbledhur informacion mbi nevojën që kanë kopshtet, të cilët kanë fëmijë me aftësi të kufizuara, për mësues ndihmës dhe më pas të procedojmë me zgjidhjen e problematikave dhe emërimet”.*

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me pretendimin e ankueses për trajtim të disfavorshëm nga ana e Bashkisë Korçë, DAR Korçë dhe Kopshti nr.11, për shkak të racës dhe aftësisë së kufizuar.

Legjislacioni shqiptar në fushën e arsimit i jep përparësi të dukshme, trajtimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara, në institucionet arsimore shqiptare. E drejta për arsimim është një e drejtë kushtetuese, e përcaktuar në nenin 57 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e cila po ashtu gëzon një mbrojtje të posaçme nga Konventa e OKB-së “Për të drejtat e PAK”.

“Konventa e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara” e ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 108/2012, datë 15.11.2012, i ofron mbrojtje personave me aftësi të kufizuar, duke ndryshuar para së gjithash, trajtimin e aftësisë së kufizuar nga ai bazuar në modelin mjekësor, në trajtimin sipas modelit social. Konventa ka për qëllim të nxisë, të mbrojë dhe t’u sigurojë që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre. Parimi i mosdiskriminimit është një ndër parimet e kësaj Konvente, ku ofrohet një mbrojtje e veçantë për fëmijët me aftësi të kufizuar, për të siguruar që këto fëmijë të gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut njësoj si të gjithë fëmijët e tjerë.

Në pikën 12 të nenit 23 të ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, parashikohet se: *“Në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për: 12. Administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe”.*

Në këtë kuadër, legjislacioni shqiptar u ngarkon detyra të rëndësishme njësisive arsimore vendore dhe drejtuesve të institucioneve arsimore, lidhur me mënyrën, se si duhen asistuar dhe krijuar kushtet e nevojshme dhe të përshtatshme në mësimdhënie për nxënësit me aftësi të kufizuara. Qëllimi kryesor i këtij legjislacioni në tërësinë e tij, është krijimi i të gjithë kushteve të

⁵ Ndryshuar me ligjin nr.48, datë 23.07.2018, hyrë në fuqi në datë 19.08.2018.

nevojshme, që këta fëmijë të mund të arsimohen njëlloj si të gjithë fëmijët e tjerë, si dhe ajo që vlen të theksohet më tepër është prioriteti i këtij legjislacioni për t'i përfshirë dhe integruar ata në institucionet arsimore të zakonshme.

Nën këtë frymë konsiston edhe përmbajtja e nenit 63, pika 2 e ligjit nr. Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, ku parashikohet: *“Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucionet arsimore të specializuara për ta është përgjithësisht e përkohshme. Përfshirja dhe integrimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshtet dhe shkollat e zakonshme të arsimit bazë është parësore”*.

Në pikën 1 të nenit 55/1 të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, parashikohet se: *“Drejtori i institucionit arsimor parashkollor emërohet nga kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse, pas propozimit të dy kandidatëve që vlerësohen me konkurim të hapur nga komisioni i vlerësimit.....”*, ndërsa në nenin 60/1, parashikohet: *“Në institucionin arsimor publik, përfshirë dhe atë parashkollor, pranimit dhe emërimi i mësuesit në një vend të lirë pune mbështetet në parimin e meritës dhe të drejtën për zgjedhjen e institucionit arsimor. Emërimi i mësuesit bëhet nga drejtori i institucionit arsimor, sipas renditjes në portalin “Mësues për Shqipërinë”.....”*.

Megjithatë, për të përcaktuar saktësisht, nëse një fëmijë me aftësi të kufizuara, duhet të ndjekë një institucion arsimor të specializuar apo të zakonshëm të arsimit bazë, legjislacioni parashikon:

- Në nenin 65, pika 2, të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet: *“Në institucionet arsimore të zakonshme, programi i personalizuar për nxënësin me aftësi të kufizuara hartohet nga një komision, në përbërje të të cilit janë mësues të fushave të ndryshme të të nxënës të institucionit e psikologë. Hartimi i këtij programi bëhet në bashkëpunim me prindërit e nxënësit. Ndryshimi i programit të personalizuar brenda një institucioni arsimor vendoset nga komisioni brenda institucionit, në bashkëpunim me prindërit e fëmijës”*, ndërsa në pikën 4 parashikohet: *“Njësisia përkatëse e vetëqeverisjes vendore u siguron nxënësit me aftësi të kufizuara mjediset e përshtatshme të mësimdhënies e të të nxënës, sipas standardeve të përcaktuara nga ministria”*.

Gjithashtu, Urdhëri nr. 343, datë 19.8.2013, i Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për miratimin e dispozitave normative për sistemin arsimor parauniversitar”, i ndryshuar, në pikën 1 të Nenit 95, parashikon: *“1. Drejtori i institucionit arsimor të zakonshëm ngre komisionin për nxënësit me AK, në përbërje të të cilit janë tre mësues të lëndëve të fushave të ndryshme të të nxënës dhe psikologu/punonjësi social.”*

Në Udhëzimin e Përbashkët nr.27, datë 16.08.2018 “Për vitin shkollor 2018-2019 në sistemin arsimor parauniversitar”, Kreu III/2, germa e, parashikohet se: *“Njësitë arsimore vendore dhe drejtuesit e kopshteve publike, në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore, të ndjekin me përparësi: e) Caktimin e mësuesit ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara, në ato kopshte ku*

ka fëmijë të tillë, sipas rekomandimit të dhënë nga komisioni multidisiplinar në njësitë arsimore vendore, bazuar në portalin “Mësues për Shqipërinë””.

Referuar dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit, rezulton se drejtuesit e Kopshtit Nr.11 kanë ndjekur procedurat për regjistrimin në kohë të fëmijës si dhe e kanë akomoduar atë sipas kërkesave të prindit, duke i ndryshuar grupin. Po ashtu në zbatim të legjislacionit të sipërcituar drejtuesit e Kopshtit Nr.11 kanë ngritur Komisionin⁶ e vlerësimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara, si dhe kanë hartuar Planin Edukativ Individual me të cilin është punuar me fëmijën Xh.L.

Gjithashtu, referuar shpjegimeve të dhëna nga palët, rezultoi se mosmarrëveshjet mes personelit të kopshtit dhe prindit ishin lidhur me bashkëpunimin e palëve për zgjidhjen e problemit të higjenës së fëmijës. Pavarësisht këtyre mosmarrëveshjeve, referuar shpjegimeve të personelit të kopshtit, rezulton se fëmijës nuk i ka munguar kujdesi nga ana e personelit duke marrë parasysh dhe faktin e ngarkesës që ka personeli në drejtim të kujdesit që duhesh kushtuar dhe fëmijëve të tjerë.

Në lidhje me interesimin e subjektit ankues, Komisioneri konstaton se ankuesja pas dorëzimit të ankesës nuk ka shfaqur asnjë interesim për të ndihmuar Komisionerin me informacion mbi raportin e KMCAP në të cilin të identifikohet vështirësia e fëmijës, kërkesën për mësues ndihmës drejtuar DAR-it apo Bashkisë Korçë dhe vlerësimin e bërë nga ana e Komisionit Multidisiplinar të DAR-it në të cilin do të identifikoheshin nevojat arsimore dhe shoqërore të fëmijës si dhe do rekomandohej ndjekja apo jo me mësues ndihmës.

Nga ana e inspektorit të çështjes dhe specialistes⁷ së Komisionerit pranë Bashkisë Korçë është tentuar disa herë që të kontaktohej ankuesja, por nuk është arritur të kontaktohej pasi ka qenë e larguar jashtë qytetit.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”.

⁶ Vendimi datë 26.09.2018 i Kopshtit nr.11.

⁷ Referuar e-mail-eve datë 24.01.2019 dhe datë 27.03.2019 të specialistes së KMD-së Korçë.

Nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërpërmendura, gjykojmë se fëmija i N.L, nuk është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë nga sa parashikohet në DN⁸ dhe ligjin për Arsimin Parauniversitar përmes mos përfitimit të asistimit me mësues ndihmës në procesin e të nxënit në procesin mësimor.

Për sa më sipër, bazuar në nenin 7/1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri vlerëson se Bashkia Korçë, Kopshti Nr.11 dhe DAR Korçë, nuk kanë ndërmarrë veprime që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj fëmijës së ankueses, ose që e kanë ekspozuar atë, ndaj një trajtimi të padrejtë, për shkak të racës dhe aftësisë së kufizuar, pasi ankuesja nuk ishte në gjendje të provonte gjendjen shëndetësore të fëmijës dhe rekomandimin e Komisionit Multidisiplinar të DAR-it.

Në përfundim, për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, vlerëson se, duke pasur parasysh parimin e interesit më të lartë të fëmijës dhe të drejtën e tyre për një edukim cilësor, drejtorja e kopshtit nr.11 dhe prindi i fëmijës duhet të marrin masa të menjëhershme për vlerësimin e fëmijës nga ana e KMCAP-s dhe Komisionit Multidisiplinar të DAR-it për të identifikuar nevojat arsimore dhe shoqërore të fëmijës dhe në përfundim të rezultateve të vlerësimit ti kërkohet Bashkisë Korçë, mbështetja me mësues ndihmës.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, nenin 32, pika 1/a), c), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të fëmijës së N.L nga ana e Bashkisë Korçë, Kopshtit Nr.11 dhe Drejtorisë Ralonale Korçë për shkak të racës dhe aftësisë së kufizuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja djeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

⁸ Shkurtesë për Dispozitat Normative të arsimit parauniversitar.